



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E OBILIQ-OPŠTINE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRBJITHSHME
IPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izlozje:

Nr. ~1-102
Br.

Data 24.08.2020
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI³⁹, mbledhja e 9) me dt.31.08.2020 (e hënë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit të Komunës Janar-Qershor 2020
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Obiliqit për vitin 2020 - Zyra Kombëtare e Auditimit
5. Shqyrtim i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbim të pronës së paluajtshme në mes të Komunës, parcela Nr.P-72614055-1735, ZK Obiliq (Bedri Rexhep Lohaj dhe Blerim Bahtijar Lohaj)
6. Shqyrtimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbim të pronave të cilat janë në pronësi të Komunës me pronat e paluajtshme në pronësi të Hashim (Rifat) Berisha) në fshatin Bakshi
7. Shqyrtimi i Drafte Rregullore për Ndarjen e Bursave, Kompensimin e Shpenzimeve të Udhëtimit dhe Aktiviteteve Jashtëshkollore
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Burim Gërguri



Dalje-lizenc

Nr. 1-104
Br.

Data 26.08.2020
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilic - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.30.07.2020, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Florije Jashari (AAK), Muhamet Mustafa (AAK), Qendresa Dubova (AAK), Enver Gashi (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatmir Bekteshi (LDK), Fatos Kurshumlija, (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Nora Preniqi (LB), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, drejtorët komunal, Haki Jashari, drejtor i QKMF-së, dhe përf. i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit Financiar Janar-Qershor 2020-DEFZH
4. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për lirimin nga taksa komunale për bizneset që nuk kanë punuar gjatë pandemisë Covid-19
5. Shqyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e Draft Rregullores për Shërbimet e Varrimit, Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e Varrezave
6. Shqyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e Draft Rregullores për Ndarjen e Bursave, Kompensimin e Shpenzimeve të Udhëtimit dhe Aktiviteteve Jashtëshkollore
7. Shqyrtimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbim të pronës së paluajtshme në mes të Komunës, parcela Nr.P-72614055-1735, ZK Obiliq (Bedri Rexhep Lohaj dhe Blerim Bahtijar Lohaj)
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës i cekur më lartë.

Pika e 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal ishin të pranishëm.

Pika e 2 e rendit të ditës

Aprovohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

Pika e 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Përnjë sqarim më detal të raportit financiar Janar-Qershor 2020, fjalën ia dha drejtoreshës së DEFZH-së.

Zarife Behluli– Ju njoftoj se të hyrat vetanake të planifikuara i kemi pasë 1 milion e 22,665 €,ndërsa të realizuara për këtë 6 mujor janë 436,958 €, që do të thotë se realizimi është 42.72 %. Tani, kalojmë te kategoritë ekonomike: paga dhe mëditje, grand të bartura në total janë 1 milion e 140,423.66, ndërsa shpenzim janë 2 milion e 62,423.65. Në mallra dhe shërbime në 6 mujorin 2020, janë përfshirë të gjitha Drejtoritë komunale, buxhet janë 449,749.89 ndërsa shpenzim janë 227,339.62, do të thotë 50.55 %, të shpenzuara. Shpenzime komunale, buxhet janë 187,703.06, të shpenzuara 98,573.34, që do të thotë 52,46 % janë realizimi i shpenzimeve. Subvencione dhe transfere, buxhet janë 424,693.40 €, të shpenzuara janë 126,614.32, do të thotë 29.81 %. Subvencionet në këtë vit i kemi vetëm me të hyrat vetanake. Sa i përket investimeve kapitale, e keni tabelën e të gjitha investimeve kapitale, 5 milion e 142 mijë e 5 €, janë buxhet, ndërsa të shpenzuara janë 401,879.58 €. Ju njoftoj se jemi në përgatitje për shpalljen e subvencioneve për nënat vetëushqyese dhe gratë e lira, që janë në biznes dhe aty i kemi 50,000 €.Shpallja publike është me dt.30, kështu që kërkoj nëse, e keni dikend të aplikojnë, ndërsa aplikacionet do ti shqyrton Komisioni.

Lulzim Sadiku – Në raportin financiar 6 mujor, bie në sy realizimi i të hyrave në vlerën prej 415.547 €, nga vlera e parashikuar e të hyrave prej 1 milion e 22,650 €, që është rreth 40 % realizim. Kjo mund të jetë një mesazh që ka qenë shumë vështirë me arritë planin e të hyrave, kur dihet se në fillim ka pasë problem të pandemisë dhe kymund të jetë viti i tretë që Komuna, nuk ka arritë me realizue planin e të hyrave komunale. Te pjesa e shpenzimeve në këtë 6 mujor është shqetësuese, shpenzimet në linjën e investimeve kapitale, që sipas materialit delë se vetëm 7.82 %, është realizimi ishpenzimeve. Unë kam parasysh se ka vështirësi në kohën e pandemisë si dhe është krijuar një rregullë e shpenzimeve që të bëhen në muajt e fundit. Mendoj se një planifikim më i mirë, një azhuritet më i madh i planifikuar te projektet, sidomos te puna më serioze te Zyra e Prokurimit, kishte mund me ecë më shpejtë me projekte sepse si zakonisht në fund po duhet me i shpenzue të hyrat për mos me i kthye në thesar.Vërejtja e vitit të kaluar ishte se në tërësi janë mbi 1 milion e 500,000 €, mjete të buxhetit të pashpenzuar sipas raportit 3 mujor, që e kemi marrë.

Aziz Bici – Rreth realizimit të subvencioneve, do të thotë prej planifikimit total në përgjithësi ka arritur vetëm 15.98 %, subvencionet janë në vlerën prej 112,000 €,përgjatë gjithë vitit ndërsa, janë ekzekutuar vetëm 17,100. Duhet të kemi parasysh se bujqit kanë nevojë për subvencione, kryesisht në 6 mujorin e parë kur dihet se shumica e kulturave bujqësore realizohen në këtë kohë, duhet rritur subvencionet për çdo kategori për të stimuluar bujqit nga situata e krijuar nga pandemia.Qytetarët kanë nevojë për asfalt, por të dallojmë se ata kanë nevojë edhe për interesat tjera.Mendoj se do të duhej të gjejmë mbështetje, por sido që të jetë po vazhdon avazi si në të kaluarën. Te denimet për vitin 2020, kam një pyetje sepse nuk po e kuptoj shumën prej 21,411 €,a është fjala vetëm për muajin mars, apo janar-qershor.

Kryetari – Ne të gjithë e dijmë gjendjen aktuale, jo vetëm në Komunën tonë, por edhe në tërë territorin e vendit tonë dhe më gjerë problemet që i ka shkatue dhe po ishkaktonaktualisht pandemia.Ju e dini se deri në muajin maj edhe proceset e Prokurimit, kanë qenë të ndaluara.Në vend që të fillohet të punohet në muajin mars, ne sinjalet e para i kemi marrë prej 1 majit, që i bjen se 2 muaj jemi më vonë në fillim të realizimit të projekteve kapitale dhe subvencioneve.Te të hyrat vetanake, është fat i mirë se ne 33 %, i kemi nga KEK-u, shumën që vjen dhe kemi arritë me inkasue, që kjo e ka normalizue sepse ju e dini se një pjesë e madhe e bizneseve, jo që janë vonue me pague, por realisht nuk kanë mundësi me pague.Në këtë vit duhet me pa mundësinë përsëri të rishikimit të të hyrave vetanake, të cilat nuk mund të inkasohen për shkak të rrethanave të krijuara.Fillimi i projekteve, është prej muajit maj i ekzekutimit për realizimin e tyre dhe mendoj se jemi mirë me proces edhe pse jemi vonuar 2 muaj, për shkak të pandemisë.Sa i përket qështjes së subvencionimit në bujqësi, ne e kemi planprogramin, strategjinë e cila është duke e implementue taman ashtu qysh edhekërkohet. Mirëpo, fatmirësisht ne bashkë me bujqit i kemi ndarë vijat, në të cilat bujqit pretendojmë me i subvencionue me buxhetin që e kemi të planifikuar dhe realisht jemi në rregullë në këtë drejtim.Mendoj se

planifikimi buxhetor është bërë bashkë me juve, bashkë me debatet që i kemi bërë në çdo lokalitet dhe shpresoj se për neve Ekzekutivin, prioritet janë të gjithë qytetarët dhe kërkesat e tyre, duhet me i marrë parasysh. Ne e kemi edhe problemin e rritjes së numrit të të infektuarve, por shëndetësia jonë është duke e bërë të pamundurën bashkë me policinë në terren, që ata të cilët janë të prekur të vetëizolohen në shtëpitë e tyre. Prandaj, ju sugjeroj edhe juve që aty ku e keni ndikimin të apeloni që të respektohen të gjitha masat e Qeverisë dhe IKSHPK-së.

Aziz Bici – Unëvetëm ju referova 15.98 %, duke u bazuar në prejjudikimin e juajse vetëm të një vlere janë shprehur për planifikimin. Ju thatë se e keni strategjinë dhe pasi strategjia është për pjesën e pranverës, do të thotë për 6 mujorin e parë, mendoj se përqindja është dashur të jetë më e madhe e subvencionimit të bujqëve.

Kryetari – Sqaron se ky është buxheti për 6 mujorin, realisht subvencionimi i qumështit, është çështja e trajtimit shëndetësor të kafshëve, vaksinimi, mbarësimi etj. dhe nuk kanë arritë me u mbyllë në 6 mujorin e parë sepse çdo 3 muaj bëhet barazimi. Edhe nëse, nuk janë sjellë fakturat ne e kemi bërë përmbylljen me dt.30, dhe ka vazhduar pas dt.30 e tutje. Unë jam shumë i bindur se ky është një ndryshim, muajin që jemi ne ka ndryshue me muajin e kaluar dhe ka në vazhdimësi që bëhen pagesat. Për neve, është shqetësuese nëse, zhvillimet e pandemisë mund të ndryshojnë në të ardhmen dhe me na i ndalë punimet, por mbi të gjitha është shëndeti dhe ne duhet ti respektojmë rekomandimet që vijnë nga Qeveria dhe IKSHPK-ja.

Lulzim Sadiku – Kryetari e sqaroi shumë qartë te çështja e 30 %, të hyrat e KEK-ut, por meqë Kryetari e përmendi pandeminë kisha me kërkuar që këta heronj që punojnë në Komunën tonë dhe po e bëjnë të pamundurën për qytetarët tonë, për kushtet brenda objektit të merret më shumë Zyra e Prokurimit. Në Komunën e Obiliqit, Kryetar EKG-ja, duhet të rregullohet sepse nuk po punon, fotografimi i mushkërive në ambulancë nuk bën, as fotografimi që rregullon dhëmbët. Prandaj të kisha lutë Kryetar, këtu jemi në shërbim të qytetarëve dhe të ndërmerri disa masa urgjente, ndërsa, sa i përket raportit jam shumë i qartë.

Kryetari – Fatmirësisht e kemi drejtoreshën dhe z.Haki Jasharin drejtorin këtu, dhe besoj se këta do ti trajtojnë temat që u diskutuan dhe shpresoj që në mbledhjen e radhës të na sjellin një sqarim.

Zarifë Behluli – Sqaron se në bazë të Ligjit mbi Financa Publike, gjobat i alokon Ministria e financave, çdo 3 muaj, dhe pa marrë parasysh se në cilin muaj krijohen ato gjoba, mjetet rrjedhin në llogarinë tonë pas çdo 3 mujori.

Aziz Bici – Unë kam një kërkesë që të na sjellin një raport për këto gjoba në mënyrë detale, që ne të dimë se për çfarë raste gjobiten qytetarët tonë. Pra, a është fjala për tejkalim të shpejtësisë, apo për diçka tjetër sepse shpejtësia e vozitjes prej fshatit atje, te Kosova A, deri në hyrje të qytetit është 40 km në orë, ndërsa 60 km në fshatin Milloshevë, ku afërsia e shtëpive dhe lëvizjes së qytetarëve është shumë më afër se sa në atë pjesë. Prandaj, është mirë ne me pasë një raport që të dimë se shenjat e komunikacionit a janë sipas ligjit në fuqi në Komunën tonë, apo jo.

Kryetari – Ju e dini se në hyrje është shkrimi i tabelave prej Ministrisë, edhe pse nedisaherë i kemi vendosë shenjat e komunikacionit për shkak të nevojës për qytetarët tonë. Mirëpo, duhet të bëhet kërkesa në Ministrinë për infrastrukturë nëse, ata bëjnë ndryshim ne mund ta shohim çështjen e lëvizjes së shpejtësisë në hyrje.

Fatmir Bekteshi – Unë e kam një informatë se policia e trafikut të Fushë Kosovës, dalin në territorin tonë dhe gjobitin, por në Milloshevë, pshkur delë policia mendoj se ato gjoba e kanë përqindjen nëse, nuk gaboj si të hyra Komuna jonë. Ndërsa, për Obiliq, sa i përket policisë tonë pak e respektojmë ne të gjithë.

Kryesuesi – E falenderoj Ekzekutivin, për punën e madhe që e ka bërë dhe ne si pasqyrë reale do ta kemi në muajin e 9, ose 10, raportin se kujemi me të hyra dhe me investime. Të hyrat vetanake janë tejkalue gjithëherë dhe plani është tejkalue deri në 106,107, deri në 109 %.

Pika e 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën e DEFZH-së, për lirim nga taksa komunale për bizneset që nuk kanë punuar gjatë pandemisë Covid-19.

Enver Gashi – Ne jemi për lirim nga taksa komunale, për bizneset që nuk kanë punuar gjatë pandemisë.

Lulzim Sadiku – Pajtohem që të lirohen këto biznese me këtë vlerë prej 39,000 €, por nëse janë më shumë se 270 biznese kërkoj qënëse, dalin të gjithë ata që nuk kanë punue dhe janë të regjistruar të lirohen edhe nëse rritet kjo nga 39,000 €, në 40,000 €. Pra, ka biznese që mund të mos jenë në këtë numrin 270 që janë të regjistruar në Komunën e Obiliqit, do të thotë nëse dalin 7,8 biznese, atëherë kërkoj që edhe nëse rritet kjo shifër ato biznese të lirohen për vitin 2020. Grupi i PDK-së, e përkrahë kërkesën e cekur më lartë.

Kryesuesi – Sipas Rregullores, të gjitha bizneset e regjistruara në 4, ose 5 vitet e fundit janë të liruara nga taksakomunale. Ndoshta, kishte me qenë mirë me i lirue edhe furrat, barnatoret, shitoret e mëdha etj. por atëherë do të jemi në kundërshtim me Komunat tjera, sepse ato nuk i kanë liruuar.

Aziz Bici – Është absurde të merret e suksesshme propozimi për lirim nga taksa për bizneset, që të kërkojen vetëm nga Komuna e Obiliqit dhe Graçanicës. Bizneset kontribuojnë shumë në mirëqenien e qytetarëve për punësimet, prandaj nuk duhet të shihet në interes vetëm për ti rritur të hyrat komunale. Taksat e bizneseve, duhet të hiqen tërësi ashtu si ka ndodhë në të gjitha Komunat. Për lirim nga taksat komunale në kohën e pandemisë, ne si LVV kemi marrë iniciativë për thirrjen e një mbledhjeje të jashtëzakonshme, por nuk patëm gjetë mbështjetjen nga asambleistët as te partitë, as opozitare, pasi që sipas tyre LDK-ja, kishte në plan të bënte një gjë të tillë. Sido që të jetë ne e mbështesim këtë hap që të ndërmerren edhe hapat tjerë lehtësues për bizneset, qoftë edhe në Komunën tonë. Poashtu, kërkojmë nga Ekzekutivi, që në këtë kohë pandemie ti ndalin presionet e shantazhet ndaj bizneseve për ç'është byrokratike, tendenca nga aspekti për shkak të neglizhencës së Ekzekutivit.

Armend Rushiti – Edhe ne e përkrahim kërkesën e DEFZH-së, për lirim nga taksat komunale, për bizneset që nuk kanë punuar gjatë pandemisë për vitin 2020.

Nazmi Gashi – Është rast i mirë me të një sistematizim administrativ dhe me zbatue Rregulloren si dhe ligjet në tërësi për bizneset. Të gjitha bizneset, që i plotësojnë kriteret dhe janë në rregullë në sistemin juridik administrativ, duhet ti lirojmë dhe të ju ndihmojmë. Unë e di nga përvoja se ka biznese, që nuk janë në rregullë dhe shumica prej tyre punojnë në mënyrë ilegale. Prandaj apeloj që edhe bizneset ti respektojnë format e rregullta legale, që në fund me mund me shfrytëzue të mirën që ua mundëson Komuna.

Fatmir Bektashi – Unë e pyes drejtoreshën se a janë të liruara nga taksa ata të cilëve ne ju kemi dhënë pronë në shfrytëzim dhe kemi te restorantet psh që i kemi dhënë hapësirat publike që shfrytëzohen siterrasa publike, a hyjnë në këtë pako. Këtu, nuk është ndonjë e hyrë e madhe, prandaj shikone edhe këtë çështje.

Zarife Behluli – Përgjegjet se të gjitha që kanë qenë në kohën e pandemisë lirohen nga taksat komunale. Unë mund të them se këto biznese, janë të regjistruara dhe ju e keni listën me numra të regjistruar.

Kryesuesi – Ju njoftoj se kjo është mbledhja e dytë e rregulltë e Kuvendit, pas lehtësimit të masave të lirit tonë dhe ne qysh në mbledhjen e parë kemi mendue se ndaj bizneseve duhet të marrim masa lehtësuese. Mirëpo, ne nuk kemi mund atë ditë të vendosim pa na ardhë një raport nga DEFZH-ja, me numrin e bizneseve të cilat janë aktive me të gjitha të dhënat e kompletuara.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 19 vota për e aprovuan Vendimin për lirim nga taksa komunale për bizneset që nuk kanë punuar gjatë pandemisë Covid-19.

Pika e 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën e DEFZH-së, për shqyrtimin dhe dhënien në diskutim publik të Draft Rregullores për Shërbimet e Varrimit, Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e Varrezave.

Aziz Bici – Draft Rregullorja për shërbimet e varrimit, ka specifikuar shumë gjëra, që besoj se hartuesit e saj kanë bërë mirë, por disa nene që është përgjegjësi e jona dhe Ekzekutivit, i kanë bërë të varfëra, shpresoj jo me qëllim. Psh neni 12, pika 1, "Komuna e Obiliqit, në këtë Rregullore obligohet që brenda mundësive dhe kapaciteteve buxhetore të Komunës, ti mbuloj financiarisht shërbimet e varrimit për të gjithë qytetarët e Komunës". Shprehja brenda mundësive për neve lenë hapësirë për ndasi, apo trajtim të pabarabartë të qytetarëve. Ne si LVV, mendojmë se kjo fjali duhet të formulohet kështu: "Komuna e Obiliqit me këtë Rregullore, merrë përsipër ti mbuloj financiarisht shërbimet e varrimit për të gjithë qytetarët e

Komunës”.Kjo për shkak se Komuna ka buxhet dhe duhet qytetari të mbështetet së paku në këto raste të rënda të humbjes së familjarëve. Poashtu, propozoj që të specifikohet edhe çështja e anëtarësisë kur dihet se Bashkësia islame nuk merrë përsipër pjesëmarrjennë varrim nëse, familja në fjalë nuk e ka të paguar anëtarësimin ndaj kësaj Bashkësie.Pastaj, te mirëmbajtja e varrezave neni 15, pika 1 thuhet:“Organi kompetentë i administratës DSHPE, administron me punët e varrimit të rregullimit dhe mirëmbajtjes së varrezave në qytet dhe fshatranëse, ndryshe nuk është e rregulluar me ligj”. Ne të gjithë jemi dëshmitarë të gjendjes së varrezave dhe se mirëmbajtja e tyre bëhet vetëm nga familjarët, e jo nga organet komunale. Ne kemi rastin kur në vitin 2018,një ndërmarrje e pastrimit, në vend të pastrimit të varrezave ortodokse në Milloshevë, i kanë djegur ato, për ç ka edhe është hapë rasti në polici. Ne si LVV, propozojmë që kjo pikë të formulohet kështu: 1. Organi kompetentë i administratës DSHPE, administron: a) me punët e varrimit dhe b) rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në qytet dhe fshatra duke angazhuar punëtorë gjithëandëj vendbanimeve të Komunës, sipas legjislacionit në fuqi, bashkëpunon me Bashkësitë fetare”.Ne mendojmë se Komuna duhet të siguroj mirëmbajtjen e mirëfilltë të varrezave. Në fund neni 21, i kësaj Draft Rregulloreje thotë:“Lejon varrimin e të vdekurit, lëshohet nga Zyra e gjendjes civile të Komunës, në pajtim me legjislacionin në fuqi”. Mendoj se rreth këtij neni dikush duhet me na dhënë sqarim.Pra, me shpjegimin e këtij neni dhe me ndryshimet e kërkuara të nenit 12, 15 dhe 21, do ta votojmë Draft Rregulloren, në të kundërtën do të votojmë kundër sepse me vendimet tona nuk duhet të krijojmë hamendësi as për qytetarët, as për zyrtarët komunal.

Kryesuesi – Kjo është Draft Rregullore, e cila së pari delë në debat publik, merren komentet, vërejtjet, kthehet në Komitet, pastaj aprovohet në Kuvend.

Lulzim Sadiku – Pajtohem që kjo Draft Rregullore, të delë në debat publik dhe pse është fat i mirë që Komuna e Obiliqit, këto shpenzime i ka mbulue. Ndërsa, pas debatit publik, pas dhënies së vërejtjeve në fund ne mund të bisedojmë për problemet e ndryshme.

Nazmi Gashi – Duhet të shqyrtohet çështja që kanë thënë hoxhollarët se ata që nuk e paguajnë anëtarësimin nuk do të varrosen, do të thotë të mos mbeten të vdekurit pa u varrosë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 20 vota për e aprovuan Vendimin për dhënien në diskutim publik të Draft Rregullores për Shërbimet e Varrimit, Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e Varrezave.

Pika e 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga DKA-ja, për shqyrtimin dhe dhënien në diskutim publik të Draft Rregullores për Ndarjen e Bursave, Kompensimin e Shpenzimeve të Udhëtimit dhe Aktiviteteve Jashtëshkollore.

Enver Gashi – Ne e përkrahim dhënien në debat publik të kësaj Draft Rregulloreje.

Lulzim Sadiku – Edhe pse në vitin e kaluar i kemi dhënë vërejtjet për këtë Draft Rregullore, ne e përkrahim dhënien e saj në debat publik, pastaj do ti japim vërejtjet dhe propozimet tona në Kuvend.

Aziz Bici – Ne e përkrahim daljen në debat publik të kësaj Draft Rregulloreje, por kisha me kërkuar prej juve që vërtetë, ti organizoni ashtu qysh duhet debatet publike në mënyrë, që të marrin pjesë të gjithë ata që mendojnë se mund ta japin kontributin e vet dhe në fund të jetë një Rregullore që i plotëson kushtet.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 19 vota për e aprovuan Vendimin për dhënien në diskutim publik e Draft Rregullores për Ndarjen e Bursave, Kompensimin e Shpenzimeve të Udhëtimit dhe Aktiviteteve Jashtëshkollore.

Pika e 7 e rendit të ditës

Kryesuesi–Paraqiti Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës për këmbim të pronës së paluajtshme në mes të Komunës, parcela Nr.P-72614055-1735, ZK Obiliq (Bedri Rexhep Lohaj dhe Blerim Bahtijar Lohaj)

Arben Berisha – Ju njoftoj lidhur me lëndën e këmbimit në fshatin Bakshi, se lëndën e kemi tërheqë për arsye se nuk kemi pasë marrëveshje me pronarin e parcelës. Pasi që ne e kemi tërheqë lëndën, ai ka ardhë e ka bërë deklaratën, e ka nënshkruar dhe ju do ta keni për shqyrtim në mbledhjen e radhës. Ndërsa, sa i përket lëndës së Blerim Lohaj, ne e kemi pasë në negocijim me Kryetarin, drejtëpërdrejtë për këmbim të pronës,

ashtu qysh e parashehë ligji. Unë e kam bërë prezentimin dhe i kam bërë disa skica se si duket dhe krejtë janë në pyetje dikund rreth 440 m² për këmbim të pronës që e pamundëson investimin e tij në vlerën mbi 6 milion e gjysmë. Pas vendimit tuaj mund të inicohet procedura për vlerësimin e pronave nga Ministria e financave, por pa vendimin tuaj nuk mundemi me inicue lëndën për vlerësim të pronave në Ministri të financave. Lënda është e kompletuar për inicim të procedurave të mëtutjeshme.

Aziz Bici – Pyeti se për këtë pronë, a bëhet fjalë se i njejtë e ka trashëgimitë familjes, apo është prej asaj prone, që e ka marrë për 99 vite.

Arben Berisha - Përgjegjet se prona është e tij personale që e ka blerë më heret, por përmes saj është rruga qorre, që nuk shkon mëtutje dhe është vetëm sa me ia prish investimin, që ai e ka sqarue para deputetëve në atë kohë.

Fatmir Bektashi - Së pari keni thënë se do të na sjellni material shtesë për këtë çështje dhe unë kam qenë prezentë në prezentimin e tij. Ne në atë kohë ia kemi dhënë 1 ha e 70 ari, zonë industriale dhe ky kur e ka ble atë tokë aty, ka qenë i vetëdijshëm se nuk ka dalje, por e ka ble me qëllim që me ia shpronësue autostrada. Unë kërkoj nga kolegët e mi të më mbështesin që ta shtyejmë këtë çështje dhe propozoj që të mos votojmë në këtë seancë, por ta shtyejmë për mbledhjen tjetër në mënyrë që ju të na sjellni materialin shtesë që e kemi kërkuar. Poashtu, ky ka thënë se kam me punësue njerëz të Obiliqit, por çka ka pasë me punësue 2 vetë. Ju lutem, kryesues mos na vëni para aktit të kryer.

Enver Gashi - Unë e kam parë këtë kërkesë dhe e kemi analizue si Aleancë, kështu që mund të them se ajo rrugë është rrugë qorre, që nuk i vyen as Komunës, as atij. Nëse, vendoset rruga vetëm në skaj të pronës së tij, atëherë sigurisht se do ti lidhë 2 prona e më shumë, prandaj jemi për me bë këtë ndërrim të pronave. Ne nuk humbim asgjë, përkundrazi atij operatori ia mundësojmë të bëjë investimet që i ka paraparë.

Lulzim Sadiku – Në këtë operator ia kemi dhënë një pjesë të tokës, se ky do të bëjë investim në vlerën prej 6 milion e gjysmë. Tash, investimi prej 6 milion e gjysmë nuk delë në pjesën që ia ka dhënë Kuvendi atij, por delë në pjesën që e ka blerë dhe po kërkon një këmbim në sipërfaqe prej 4 ari e 40 m. Unë pajtohem që me ditë se sa ka investue në pjesën që e ka marrë në zonën industriale, që ka premtue punësim dhe investim 6 milion e gjysmë. Meqë, nuk kemi informata të mjaftueshme edhe unë propozoj që kjo pikë e rendit të ditës, të prolongohet deri në mbledhjen tjetër. Unë do të isha pajtue në fakt, që për pjesën të cilën e ka marrë dhe ka premtue se do ta bëjë investimin edhe me bë ndryshimin në këtë pjesë për të cilën po flasim. Mirëpo, nëse ky në pjesën që e ka marrë nuk e ka bërë asnjë investim në pjesën industriale dhe tash kërkon në pjesën tjetër në vlerën e njejtë, i njejtë projekt, diç ka nuk po delë serioz. Ne duhet të kemi informata shumë më shumë që në fakt nëse, ky investon në pjesën private që e ka blerë duhet të ia, bëjmë rrugën, por atë pjesën që ia kemi dhënë zonë industriale duhet me lëshue. Prandaj, unë në emër të grupit kërkoj që kjo kërkesë të prolongohet deri në mbledhjen tjetër.

Aziz Bici -- Në këtë Kuvend, kjo legjislaturë pothuajse, në secilën mbledhje ka dhënë në shfrytëzim prona në periudhën afatgjate për 99 vite, prona komunale duke u thirrë në zhvillimin ekonomik të Komunës tonë. Kjo, në terren nuk përputhet. Pronat në shfrytëzim iu janë dhënë disa personave, apo firmave fiktive për të cilat ka dyshime se fshihen figura të caktuara të Komunës tonë. Këto, prona nuk po shfrytëzohen ashtu si duhet nga se disa prej tyre, janë lëshuar me qira. Në parim ne nuk e mbështesim as dhënien në shfrytëzim të pronave për 99 vite, dhe në këtë rast as këmbimin e pronës komunale sepse konsiderojmë se nuk i sjellin asnjë të mirë qytetarit. Kjo, Elita, kur e ka marrë në shfrytëzim për 99 vjet, këtë pronë a e ka parë se nuk ka kushte të përshtatshme, apo është bërë me marrëveshje duke u këshilluar përbrenda. Është absurd arsytimi i Kryetarit, me propozimin e tij ku thotë se firma do të investoj dhe do të marrë përsipër punësimin e punëtorëve, me kushte të barabarta. Tash, shtrohet pyetja kush i cakton ato kushte, a keni statistika të dhëna në territor të Komunës së Obiliqit, se janë punësuar nga dhënia në shfrytëzim e aq shumë pronave, nëse po në këtë mbledhje na tregoni, e nëse jo në mbledhjen e ardhshme është mirë me na dhënë një raport. Mendoj se nuk është e ndershme të kaloni të tilla propozime me interes puro personal. Ne jemi kundër si dhe gjithnjë do të ua shpjegojmë qytetarëve këto vendime të dëmshme, por do të vijë dita që dikush do të japë përgjegjësi.

Armend Rushiti – Edhe ne propozojmë që ky Propozim Vendim i Kryetarit të Komunës, të prolongohet për mbledhjen e ardhshme, në mënyrë që të na vjen lënda e kompletuar.

Slavisa Spasic – Ne jemi për atë që të votohet.

Nazmi Gashi – Kryesues, kur është kërkesa e një anëtari të Kuvendit, për me prolongue diçka, mendoj se është mirë ne si kolegë të mendojmë sepse nuk jemi për atë që ti pengojmë proceset. Unë kam qenë pjesëmarrës kur ka debatue investuesi për këtë pjesë dhe besoj se është investim i mirë megjithatë, ne mund ta shtyejmë këtë çështje për mbledhjen tjetër që të arsyetohet më mirë.

Shaip Paloja– Mendoj se këtu, gjërat janë gabuar sepse po flitet për dy çështje që nuk kanë të bëjnë fare njëra me tjetrën. Unë kam qenë në prezentim të atij biznesi, kur është bë në Komunë dhe qysh atëherë, ai ka treguar se ka një pronë private të blerë më heret, që mendon të investoj dikund mbi 6 milion, kryesisht në ndërtimin e mobiljeve. Ai qysh e ka prezentue, bëhet fjalë për një teknologji të fundit në rajon, ndoshta edhe më gjerë dhe kjo nuk ka të bëjë me atë pjesën që ne ia kemi dhënë në zonën industriale për biznes. Mendoj se është mëkat i madh për një rrugë të mos i mundësohet investimi Komunës tonë, mbi 8 milion. Sa i përket kushteve, dihet se kontrata do të bëhet dhe ne brenda kontratës mund ta kushtëzojmë atë për punësim, për kushte të barabarta dhe për të gjitha të tjerat që janë interes i Komunës tonë. Mendoj se është gabim i madh ta bëjmë një lëshim të tillë, duhet ti mundësohet biznesit, jo vetëm këtij, por të gjitha bizneseve tjera, të invstojnë në Komunën tonë, ata që kanë mundësi. Në këtë rast mundësitë janë shumë të mira, në pronën private po investon biznesi, ne vetëm duhet të ia sigurojmë një rrugë, në fakt të këmbimit të një prone publike me atë private.

Fatmir Bekteshi– Unë po citoj së pari se çka ka thënë ai te punësimi. Në fillim ai tha se dua të tregohem shumë i sigurtë se nuk marrë punëtorë përveç një rojtar dhe një pastrues sepse e kam teknologjinë shumë të avansuar. Këtu, unë kam qenë në dyshim dhe kemi thënë në Komitet të na sjellni materialin shtesë, pastaj ne votojmë dhe unë nuk votoj.

Enver Gashi – Z.Shaip, shumë mirë e sqaroi çështjen të mos i përziejmë gjërat se çka ne i kemi dhënë dhe çka ai ka në pronësi të vetën. Këtu, bëhet fjalë për 4 ari, për një rrugë qorre që neve nuk na vyen kurrë, por edhe asnjë qytetari sepse është në mes të pronës së tij. Ajo rrugë nëse, delë në skaj të pronës së tij sigurisht se është në pozitë më të mirë sepse lidhë prona më shumë për qytetarë. Unë nuk po e shohë asnjë arsye që ne ta prolongojmë këtë çështje për mbledhjen e ardhshme. Ne qëllimin kryesor si Komunë, për dhënien e pronave në shfrytëzim e kemi që të ngritet ekonomia në Komunë, të ngritet punësimi. Tash ta shtyejmë këtë çështje pse i teket dikujt, apo për inate personale, nuk e shohë të arsyeshme. Ne një mbledhje para kësaj një kompani që nuk e ka plotësue dokumentacionin veç ia morëm atë të drejtë dhe njëjtë nëse, kemi arsye mund të ia bëjmë edhe këtij për pronën e dhënë për 99 vjet, por jo me tekete e dikujt.

Lulzim Sadiku – Unë kërkoja që kjo çështje të prolongohet sepse personit në fjalë ia kemi dhënë 1 ha e 70 ari, në zonën industriale, që ka premtue punësim dhe 6 milion e gjysmë investim. Ne atij ia kemi dhënë pronën me qëllim që ai investimin ta bëjë në zonën industriale dhe shumë më lehtë kishim mund me i dhënë jo 4 ari, por edhe 40 ari, që e di se nuk është për me ia dhënë, por me bë ndyshim për 40 ari. Mirëpo, është i njëjti investim 6 milion e gjysmë në 1 ha e 70 ari, zonë industriale dhe në zonën private të tij është i njëjti investim 6 milion e gjysmë. Unë isha shumë i qartë për shkak të kohës së shkurtë që i kemi 30 ditë, me cekë 1 ha, e 70 ari, që ka premtue 6 milion e gjysmë e 30 punësime, qysh do të vepron ai sepse ia kemi dhënë. Sa i përket pjesës që është kthyer prapa, vendimi i vetëm është marrë për shkak se operatori i cili e ka marrë parcelën nuk i ka përmbushë kriteret për kërkesat që i ka pasë. Ne nuk e kemi dhënë vetëm një parcelë, por me mijëra, e punësimi te këta është ende 0. Ne po kërkojmë të shtyhet kjo çështje, vetëm me arsyen që të dijmë saktë se 6 milion e gjysmë, a do të investohet në pjesën që ia kemi dhënë, apo në pjesën e tij private.

Hysni Mjeku – Unë po kyqem në diskutim, pasi që jam anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa. Këtu, u dëgjuan disa akuza pa i potencuar x personat, do të thotë nuk duhet me folë krejtë në mënyrë paushalle se kush qëndron prapa bizneseve, se kush po i ndihmon dikujt. Këtu, nuk jemi organ hetues, as gjyqësor, por ne po i bëjmë zgjidhje individit për pronën e vet private dhe as Komuna, nuk po humbë shumë dhe biznesi po fiton sepse po i bëhet një zgjidhje këtij biznesi. Ne nuk duhet ti ngatërojmë pronat private me pronat

publike sepse vërtetë po i bjen anomali nëse, ne si anëtarë të Kuvendit, nuk kemi informacione sa duhet. Komiteti për Politikë dhe Financa, i shqyrton dhe i analizon bukur mirë gjërat dhe ne konsiderojmë se Komiteti është organ profesional që i ndihmon këtij Kuvendi. Prandaj, akuzat se kush qëndron prapa duhet ti lejmë sepse nuk i dijmë dhe sot psh nëse, unë e di se kush qëndron prapa sinqerisht do ta paraqesë në Gjykatë. Ato gjëra janë të rënda ti thuash dikujt se qëndron prapa, atëherë thuaje emrin dhe urdhëro përgjegju para organit kompetentë. Ne këtij biznesi, nuk mund të ia imponojmë punësimin dhe këtu Komuna, nuk po humbë por fiton biznesi, do të thotë atë pronë ai don me shfrytëzu në mënyrë maksimale. Unë jam pro sepse Komuna, nuk po dëmtohet në këtë drejtim.

Aziz Bici – Dallimi a e dini se ku është këtu, se ju në kohën e privatizimit të pronës, Agjensionin Kosovari Mirëbesimit (AKM), ju tani me të drejtë me atë politikën e juaj e quani pronë private. Mos harroni se ato prona, që po flitet se janë marrë për shkak se duken sitoka bujqësore sepse po flitet për tokat poshtë nën sistemin e ujitjes. Unë edhe si individ në atë kohë, por edhe si Vetëvendosje, kemi qenë kundër mënyrës së dhënies së këtyre pronave prej AKM-së. Unë kam argumente të mjaftueshme se keni sabotue me mënyrën qysh e ka dhënë këtë prone AKM-ja, sepse të jepet toka me qindra hektarë nën sistemin e ujitjes për tokë bujqësore dhe sot të mos krenohemi ne me një bujqësi, më shumë se sa sabotim nuk di se çka duhet me i thënë kësaj pune. Tash, interesi këtu, është se dikush ka përfitue ashtu, që me i marrë tokat bujqësore për me i shfrytëzue më vonë, me i kthye në toka ndërtimore qyshvazhdimisht është duke i bërë ky Kuvend komunal dhe dikush tjetër ka përfitime për bujqësi, këtu është gabimi. Ne do të jemi dëshmitarë dhe mendoj se në të ardhmen ky popull duhet me i çelë sytë, duhet me ditë çka me kërkue përgjegjësi prej juve, që i keni përfaqësue këto parti politike, që e keni dëmtue aq rëndë popullin. Në rast se ju, tash ma dokumentoni mua, se për këtë tokë që po flasim nuk po flitet për tokën që është privatizue dhe atë që e diskutova unë, do të thotë ju menduat se po flitet vetëm për gjendjen e tokave për 99 vite. Nëse nuk është ajo, atëherë është kjo tjetra sepse vërtetë AKM-ja dhe AKP-ja, e ka dëmtue rëndë bujqësinë dhe zhvillimin e përgjithshëm të këtij vendi duke votuar ju, mendoj për interesa të vogla dhe në të ardhmen do të flasim edhe me emra.

Kryesuesi – Z. Aziz, është mirë me iu përmbajtë rendit të ditës dhe me folë për temat konkrete. Ne kur e votuam rendin e ditës nuk pati propozim për shtyrje të ndonjë pike të rendit të ditës. Unë mund të ju them se është propozim zyrtar i Kryetarit të Komunës, janë fletat poseduese, janë parcelat dhe është kërkesa. Duhet të keni parasysh se ne tokë nuk po japim, vetëm po e ndërrojmë dhe për këtë vendos Kuvendi.

Lulzim Sadiku – Atij nuk mundet me iu dhënë leje pune hiç sepse asnjë objekt atje, nuk ka leje. Këtë e dijmë të gjithë dhe ne nuk mund ti japim leje. Përndryshe, kemi të drejtë me shtye edhe pse është në rend dite dhe propozimi im për prolongim është krejtë i drejtë.

Kryesuesi – Të nderuar, anëtarë të Kuvendit, tash i kemi 2 propozime, propozimi i parë është të votojmë sotndërsa propozimi i dytë është që kjo pikë të prolongohet për mbledhjen tjetër. Tani, e hudhi në votim propozimin e parë për këmbim të pronës së paluajtshme në mes të Komunës, parcela Nr.P-72614055-1735, ZK Obiliq (Bedri Rexhep Lohaj dhe Blerim Bahtijar Lohaj).

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 8 vota për dhe 9 vota kundër nuk e aprovuan Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës për këmbim të pronës së paluajtshme në mes të Komunës, parcela Nr.P-72614055-1735, ZK Obiliq (Bedri Rexhep Lohaj dhe Blerim Bahtijar Lohaj).

Pika e 8 e rendit të ditës

Lulzim Sadiku – Paraqet një deklaratë të përbashkët të Kuvendit komunal në Obiliq, për ti mbrojtur vlerat dhe luftën e UÇK-së. Ne anëtarët e Kuvendit komunal në Obiliq, publikisht mbështesim këtë deklaratë të përbashkët për mbrojtjen e vlerave të UÇK-së dhe besojmë në pastërtinë e luftës së UÇK-së. Ne konsiderojmë se lufta e UÇK-së, ka qenë një luftë e drejtë në përputhje me normat, standardet, Ligjet dhe konventat ndërkombëtare, ndaj pushtuesit serbë i cili ka vrarë, masakruar popullsinë shqiptare duke përfshirë fëmijë dhe pleqë. Shprehim solidaritetin tonë me udhëheqjen e UÇK-së, veçanërisht të Presidentit Hashim Thaqi dhe Kadri Veselit, të cilëve iu është ngritur aktakuzë për krime lufte dhe besojmë fuqishëm në pafajësinë dhe pastërtinë e tyre. Poashtu, shprehim mirënjohje për kontributin e secilit pjesëtar të UÇK-së, për çlirimin e Kosovës.

Aziz Bici – Lidhur me deklaratën e propozuar nga grupi i PDK-së, i Kuvendit komunal të Obiliqit, mendoj se kjo deklaratë së pari nuk iu është referuar asnjë Rregulloreje, dhe asnjë ligji. Së dyti, ne nuk kemi qenë largë dhe kemi mund të konsultohemi që të dijmë se çka po votojmë. Unë kam vërejtje shumë të mëdha se pas 21 viteve, ne si Kuvend komunal ende po e qesim luftën tonë të UÇK-së, në nivel të dyshimtë se ka qenë luftë e drejtë, vetëm juve po ju shohë. Pastaj, ne besojmë në drejtësi, do të thotë me luajtë me memorien tonë historike që jemi vetë pjesë e saj dhe ne sikur të mos kishim besuar nuk kishim me bë atë luftë. Unë pa qenë i angazhuar në politikë dhe që nga viti 2002, që jam kyqë në politikë kam qenë kundër kësaj Gjykate speciale, vetëm për një arsye se unë kam besuar në luftën tonë sepse unë e kam ditur se Serbia është armiku ynë. Prandaj, iu kam bashkangjitur luftës dhe kam luftuar, e jo kur ti teket dikujt herë po e bëjë, e herë nuk po e bëjë sepse kompetencat e këtij shteti iu kanë dorëzue pikërisht asaj Gjykate, që i merrë parasysht vetëm dëshmitë të cilat i ofron Serbia. Tani, sot ne të luajmë këtu, jo po bëjmë deklaratë, e jo nuk po bëjmë deklaratë, por deklaratë më e fortëse ne mos me u korruptue, mos me bë nepotizëm, mos me i kontribue krimin të organizuar, nuk ka. Kjo ka qenë misioni i UÇK-së, me bë shtet, e jo me u korruptue. Unë do të jem kundër kësaj sepse kjo është një politikë për me përfitue prej rasteve, sepse po të mos ishte kjo, as që iu kishte ra ndërmendë. Unë duke qenë pjesë e UÇK-së, batalioni i parë i brigades 142, zona operative e fshatit të UÇK-së, që shtrihet nga maja e zezë ku po doni me ndërtue gurëthyes, e ku po doni me dëmtue natyrën, po e dëmtoni historinë sepse ne atje kemi kujtime, që kemi pasë edhe beteja luftë kundër armikut dhe kemi dalë të suksesshëm. Këtë, po e them sepse nuk ka qenë luftë guerile, por ushtri dhe mund të themi se ka qenë luftë e kombinuar sepse çdo ushtri çlirimtare është luftë e kombinuar prej luftës guerile të armatosur, partizane dhe frontale. Fshatrat Shipitullë, Sibofc, Palaj, Lajthishtë, Hamidi, këto fshatra të Komunës tonë dhe fshatrat tjera, të Komunës së Vushtrisë Zhilivodë, Strofc, Beqok, Mihaliq, Dërvar, Gllavatin dhe Bivolak, këto fshatra po i përmendi me ua heqë dyshimet se ne nuk kemi bërë luftë të drejtë, si nuk kemi bërë luftë të drejtë ore dhe ai që ju thotë ju gënjen. Ju, e dini se 2 fshatra i kemi pasë përballë Qyqavicës, Prelluzhën pothuajse qind për qind etnikisht të komunitetit serbë dhe të tjerë dhe fshatin Plemetin, të përzier me shqiptarë dhe të tjerë. Ne kemi pasë mision me mbrojtë popullin tonë, pronën tonë, vendin tonë, ishte luftë kundër armikut, që armik i vetëm ka qenë Serbia, me njerëzit e mobilizuar në ushtrinë armike të tyre. Prandaj largone dyshimin sepse të gjithë ata politikanë që sot po i vajtojmë kanë thënë i besojmë drejtësisë, por çka ke me i besue drejtësisë ka qenë luftë qytetare dhe u krye.

Kryesuesi – Ju njoftoj se kjo deklaratë nuk i nënshtrohet vlerësimit të ligjshmërisë dhe është deklaratë e vullnetit politik për mbështetjen e vlerave dhe luftës së UÇK-së.

Lulzim Sadiku – Sa i përket rendit të ditës, unë e kam bërë një analizë bukur të thellë dhe e kam shkruar një deklaratë, në të cilën e kam shprehë mendimin tim në kuadër të luftës dhe njerëzve të saj. Në rastet e fundit që kanë ndodhë në çdo Kuvend komunal, dikund kanë marrë vendime, e dikund deklaratë dhe unë e kam paraparë të jetë deklaratë. Unë kam respekt për parafolësin, për luftën dhe kontributin e tij, por në kuadër të deklaratës nuk ke ku të bazohesh në ndonjë Rregullore sepse kjo është deklaratë dhe sikur të ishte vendim unë do të kisha hy te MPL-ja, dhe kisha me i nxjerrë të gjitha Rregulloret dhe vendimet. Mirëpo, në kuadër të deklaratës, e kam dhënë pa Rregullore dhe standarde sepse deklarata me vendim ndryshon. Unë kërkoj në mënyrë kolegjiale nga gjithë Kuvendi, që ta votojmë njëkohësisht edhe nga anëtarë i LVV-së, z. Aziz Bici.

Nazmi Gashi – Është shumë interesante se Kuvendi komunal, po e nxjerrë një deklaratë për diçka që e dijmë të gjithë sepse tërë bota është ngritë me shpjegue drejtësinë e luftës në Kosovë. Ndërsa, ne sot po enxjerrim një deklaratë se a është e drejtë ajo luftë, apo nuk është e drejtë. Më e drejtë se ajo luftë që e ka bërë populli bashkë me UÇK-në, dhe nëse, UÇK-ja denohet për diçka që nuk është e drejtë të denohet, atëherë denohet i tërë populli i Kosovës sepse luftën e ka bërë populli. Pra, pasojë e kësaj që po bisedojmë është 21 vjet, padrejtësi që është bërë ndaj qytetarëve, po them për Komunën tonë, që e dijmë se është bërë edhe në Komunat tjera, sepse nuk është vlerësue qytetari që e ka dhënë ndihmën dhe nuk është vlerësuar gruaja që e ka dhënë bukën. Poashtu, sot nuk kemi shenja ku kanë qëndruar ushtarët e UÇK-së, nëpër objektet shtëpi ku kanë jetue qe 21 vjet. Ne është dashur vetë me krijue historinë, vetë është dashur me mbrojtë drejtësinë dhe e di se neve, na kanë mbrojtë në Gjykatën ndërkombëtare që kemi qenë të drejtë.

Mirëpo, pse ne me lejue veten me ardhë deri te kjo pikë sepse jemi një popull që ka akademi, një popull që ka pasë komandantë e udhëheqës lufte dhe sot ne me nxjerrë një deklaratë. Ne do ta votojmë deklaratën, por jemi vonue.

Kryesuesi – Një deklaratë të tillë ky Kuvend, e ka votue edhe për ish Kryeminitrin z.Haradinaj, dhe nuk është ç është se jemi vonue, apo nuk jemi vonue, por është përkrahje morale dhe do të jemi çdoherë.

Aziz Bici – Kryesues, lexoje tekstin dhe kur mundohesh brenda saj je duke e denuar UÇK-në, e vëni në dyshim, pastaj ju i besoni drejtësisë. Ju vetë, keni qenë pjesë e saj me familje, me popull dhe ç ka me i tregue ne njëri tjetrit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për, 3 vota kundër e miratuan Deklaratën e përbashkët të Kuvendit komunal në Obiliq, për të mbrojtur vlerat dhe luftën e pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Pika e 9 e rendit të ditës

Kryesuesi – Ju uroj festën e Kurban Bajramit dhe kërkoj prej juve të kontriboni në vetëdijësimin e masave mbrojtëse sepse ne duhet ti respektojmë vendimet e Qeverisë dhe rekomandimet e IKSHPK-së.

Shaip Paloja – Edhe Kryetari e tha se në Komunën tonë, për çdo ditë po rritet numri i të infektuarve me Covid – 19. Unë dua ta di si informatë mundësisht se Instituti i mjekësisë së punës në KEK, nëse eventualisht ka nevojë, a do të merret ndonjë iniciativë të përdoret së paku për Komunën tonë, të hospitalizohen njerëzit që janë të infektuar, saka kompetencë Komuna dhe a kanë marrë ndonjë iniciativë Komuna.

Kryesuesi – Sqaron se nëse, aktivizohet Ligji për menaxhimin e emergjencave kombëtare krejtë resurset janë në shfrytëzim edhe spitalet, çdo institucion dhe privat.

Aziz Bici– Mendoj se thirrja jote për të dhënë kontribut, për ti respektue këshillat e IKSHPK-së, vetëm formalisht po e bën. Unë ju bëj thirrje juve, që jeni pjesë e Qeverisë që ju të ndikoni te ministrat dhe Kryeminsitri që ti kryejnë obligimet e veta, sidomos Udhëzimet që i jepë IKSHPK-ja, me i respektue të gjithë, e sidomos ta votojnë Ligjin për Covid -19.

Ibush Mjekiqi – Sa i përket situatës së të infektuarve në Komunën tonë, janë 40 persona aktiv me Covid – 19, dje kanë qenë 5, ndërsa për sot ende nuk kam informacion. Ne e kemi aktivizuar objektin ndihmës në QKMF, që ekskluzivisht mrret me trajtimin e pacientëve me Covid – 19 dhe në këtë drejtim doktoresha është vazhdimisht e angazhuar. Momentalisht situatën e kemi nën kontrollë dhe fatkeqësisht deri më tash i kemi 8 të vdekur, 6 janë të konstatuar dhe 2 raste i kemi një nga Anglia dhe njëri ka vdekë në Shkup. Të gjithë këta persona kanë pasë sëmundje kronike të brendshme dhe në momentin e fundit janë prekë me Covid-19, që për fat të keq edhe kanë pësue me fatalitet. Ne qëndrojmë mirë me furnizime dhe është e vërtetë se rëntgeni është jashtë funksionit për shkak të një prishje elektronike, ndërsa të gjitha tjerat janë në funksion. Sa i përket Institutit të mjekësisë së punës, ne jemi në kontakt të vazhdueshëm dhe nëse, paraqitet nevoja ne do ti vazhdojmë kontaktet, por për momentin endenuk është e nevojshme.

Lulzim Sadiku – Unë e kam përmendë edhe ultrazërin se Komuna e Obiliqit, nuk ka dhe kjo më ka ndodhëkëtë të diele që kam qenë vetë pas orës 23 e 10 minuta. Mirëpo, edhe në ndërrimin e natës më thanë se nuk kemi fare ultrazë, do të thotë se ambulanta në Obiliq, nuk ka fare ultrazë.

Ibush Mjekiqi – Sqaron se QKMF-ja, në Obiliq ka ultrazë dhe ju e dini se në vitin e kaluar është blerë ultrazëri, që ka qenë në kuadër të investimeve kapitale, por në ora 24, askush nuk ta bën ultrazërin.

Lulzim Sadiku – Unë kërkoj falje se nuk e pata me qëllim sepse po ta kisha pasë me qëllim, unë do të kisha shkruar nëpër rrjetet sociale. As EKG-ja, as ultrazëri nuk ka funksionue dhe të gjitha ato që ia kam thënë Kryetarit nuk janë në shërbim sepse unë kam qenë natën dhe ditën dhe tash mund të shkojmë, por nuk janë gjendje me ta bë një ultrazë.

Armend Rushiti – Sa e di unë duhet me pasë stafin e trajnuar për këtë punë dhe nëse, nuk ka staf të trajnuar

atëherë ultrazëri mjafton me qenë vetëm si pajisje. Staf i trajnuar duhet me qenë edhe te rastet urgjente, do të thotë kur dyshon diçka në urgjencë dhe nëse, nuk ka staf të trajnuar atëherë nuk ka qysh me u bë.

Kryesuesi – Për shërbimet që sot i ofron QKMF-ja, në Obiliq duhet me pasë respekt për ata njerëz dhe mos harroni se ne nuk kemi spital regional, prandaj edhe duhet me i dërgue njerëzit në emergjencë.

Lulzim Sadiku – Unë i kam përgëzuar për punën që e kanë bërë punëtorët shëndetësorë edhe në nivel ndërkomëtar dhe te aeroporti, por ultrazëri në Obiliq nuk bën, EKG-ja, fare nuk bën as ditën, as natën nuk bën, me bë një fotografim të mushkërive nuk bën. Këto, janë që nuk bëjnë.

Kryesuesi – Kryetari ju tha se për këtë çështje në mbledhjen e radhës do ta keni përgjegjen.

Aziz Bici – Mbetetme na dhënë një përgjegje Kryetari pas konfirmimit që e bëri z.Armend, i cili tha se nuk ka staf të trajnuar, a ka apo nuk ka staf të trajnuar.

Nazmi Gashi – Mendoj se Kuvendi, mund ta formoj një Komision i cili e verifikon gjendjen dhe e nxjerrë të vërtetën.

Ibush Mjekiçi – Sqaron se i vetmi aparat që nuk është në funksion tani është rëntgeni, për të cilin për çdo ditë po bëjmë përpjekje me futë në funksion. Unë e them me përgjegjësi të plotë se qytetarëte kanë shfrytëzue dhe e dijnë se qe një muaj e gjysmë rëntgeni nuk punon, ndërsa 7 vite, ka punue pa asnjë prishje. Pra, ka ndodhë në kohën e pandemisë është prishë dhe nuk bën. Shërbimet shëndetësore në Kosovë, jepen në 3 nivele dhe këtë e ka bërë Ligji për shëndetësinë, e jo ne. Në kujdesin primar futen të gjitha shërbimet qëi përkasin mjekësisë familjare dhe këtu janë të specializuar shumica e mjekëve, prej 29 që janë deri më tani i kemi 12 specialistë të mjekësisë familjare, 2 janë në specializim ndërsa të tjerët janë në fusha të tjera. Këta, janë të obliguar që gjatë specializimeve të profesionalizohen edhe për ultrazë, EKG etj. Në të kundërtën çdo mjek familjar mund ta bëjë EKG-në, në rast nevojë sepse çdoherë nuk bëhet, ndërsa ultrazëri nuk bëhet ne ora 12 të natës, sepse nuk është emergjencë.

Armend Rushiti – Nuk ka staf të trajnuar për përdorimin e këtyre pajisjeve.

Aziz Bici – Pyeti se a ka staf të trajnuar për ultrazë.


Ibush Mjekiçi – Përgjegjet po dhe mund të bëhet. Ne e kemi edhe shërbimin gjinekologjik me ultrazë.

Aziz Bici – Nën kryetari e përmendi rastin e gjinekologjisë sepse ultrazëri nuk ka të bëjë vetëm me gjinekologji, dhe pyes se a ka staf të trajnuar vërtetë, apo nuk ka.

Ibush Mjekiçi – Z.Armend, e din shumë mirë por nuk don me tregue dhe ultrazëri mund të bëhet në QKMF, në Obiliq.

Mbledhja përfundoi në ora 13:26'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit komunal


Busim Gërguri